



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0578

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Kimete Gashi dhe Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare duke vendosur sipas ankesës së OE N. P.T. " Haxhijaha" Sh.p.k., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me pajisje për pastrimin e kryeqytetit” me numër të prokurimit 616-23-7016-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, më 07/08/2024, mori këtë:

Vendim

1.Hedhet si e palejuar (palë pa interes) ankesa e N.P.T. “Haxhijaha” ShPK me nr. 2024/0578 , e datës 01/07/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me pajisje për pastrimin e kryeqytetit” me numër të prokurimit 616-23-7016-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës.

2.Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues Komuna e Prishtinës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

3. Bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 13.07.2023 Komuna e Prishtinës, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me pajisje për pastrimin e kryeqytetit” me numër të prokurimit 616-23-7016-1-1-1.

Me 10.06.2024, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, me të cilin ka shpërblyer me kontratë OE "VIBTIS".

Me 13.06.2024, OE “Haxhijaha” ShPK ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 25.05.2024.

Me 01.07.2024, OE “Haxhijaha” ShPK ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokollit 2024/0578, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për dhënie të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Haxhijaha” ShPK janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) : “ Ne letrën standard për tenderuesin e eliminuar, ne e kemi pranuar këtë letër me pretendimin e AK-se përkatësisht nga komisioni vlerësues se dëshmitë e ofruara nga ne te AK-ja për ISO Standardin 9606-1:2017 për komisionin vlerësues nuk janë bindëse, për neve si OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit është e papranueshme ngase ne përgjigjen që ne I kemi ofruar komisionit vlerësues të AK-se kemi shpjeguar dhe dëshmuar diferencën/dallimet ndërmjet standardit të kërkuar nga AK-ja dhe atij të dëshmuar nga ne. Për më tepër është e papranueshme që të eliminohet një operator ekonomik nga një tender i vlerës se madhe “me bindje” të komisionit vlerësues kur ne përveç që kemi shpjeguar fakte bindëse po ashtu I kemi ofruar komisionit vlerësues edhe shpjegimin i cili është lehtë i qasëshëm në faqet e internetit dhe është lehtë i verifikueshëm pasi këto faqe janë ndërkombëtare dhe me renome. Për të vërtetuar saktësinë tonë si dhe për të ndihmuar e lehtësuar punën komisionit vlerësues ne përgjigjen tonë rreth sqarimeve shtese i kemi treguar edhe websitin zyrtar të ISO STANDARDEVE, ku shpjegohet dallimi ndërmjet ISO 9606-1: 2014 dhe atij ISO 9606-1:2017. Dallimi i vetëm qëndron në vitet kur ky standard ISO9606-1 është rishikuar ndërsa thelbi ka mbetë i njëjti, pra ISO 9606-1. Ato janë vetëm rishikimet të rregullta pa ndonjë ndryshim. Po ashtu ne dosje të

tenderit tek FTD-ja pika 9.1&9.2 te cilat kane te bëjnë me kërkesat mbi përshtatshmëritë teknike dhe/ose profesionale AK-ja ka kërkuar citoj: OE duhet te dorëzoj një certifikata te vlefshme për testimin e kualifikimit te saldatorve sipas standardit EN ISO 9606-1:2017 (ose standardit kombtar ekuivalent) për te paktën 5 saldatorve te punësuar nga prodhuesit e superstrukturave me dëshmi punësimi. Pra AK-ja ka lejuar/kërkuar edhe standard ekuivalente, ne kemi ofruar standard internacional qe ka te beje me saldator, ndërsa komisioni vlerësues na eliminon se nuk është i ngjashëm. Veprimi i komisionit dhe kërkesa e AK-se ne dosje te tenderit janë ne kundërshtim, andaj ky pretendim i AK-se për eliminim tonin është i paqëndrueshme dhe sit e tille ne kërkojmë nga AK-ja ta beje rishqyrtimin e vendimit mbi dhënie te kontratës, lenden ta kthej ne rivlerësim dhe ne te cilësohemi si te përgjegjshëm. Neni 70 I LPPK-se qe ka te beje për Standardet për Sigurimin e Cilësisë – thotë , citoj: Autoriteti kontraktues do t'i pranojë certifikatat e barasvlershme të lëshuara nga cilido organ certifikues pavarësisht nga vendi, nëse organi i tillë pranohet nga një shtet anëtar i BE-së. Pra AK-ja përkatësisht komisioni vlerësues me vendimin dhe pretendimin tuaj te justifikuar si “JO BINDESE” keni bere shkelje te këtij neni ngase sipas tij ju si AK do te duhej ti pranoni edhe certifikatat te barasvlershme me kërkesën tuaj ndërsa certifikatën e prezantuar nga ne jo qe nuk I keni marr për baze por e keni cituar si “JO BINDESE”. Eliminimi nga një aktivitet prokurimit I cili është i “VLERES SE MADHE” me arsyetimin qe dëshmitë nuk janë bindëse pa dëshmuar asnjë prove për neve si Operator Ekonomik është i papranueshëm. Komisioni vlerësues do te duhej te vlerësoj tenderat ne baze te fakteve, dokumenteve e jo me pretendimet qe te kërkojnë nga Operator ekonomik ti bindin ata, e aq me tepër kur ne si operator ekonomik fillimisht kemi dërguar këtë standard sipas kërkesës se AK-se ne dosje te tenderit e pastaj edhe ku është dallimi midis EN ISO 9606-1 2014 dhe atij EN ISO 9606-1 2017. Ne përgjigje e pranuar nga AK-ja ne kërkesën për rishqyrtim (shih te bashkangjitur) AK-ja përkatësisht komisioni vlerësues përmend qe ne si OE kemi dorëzuar një certifikata tjetër (EN ISO 9609 1 2014) ne vend te asaj te cilën AK-ja e ka kërkuar ne dosje te tenderit. Ky pretendim i AK-se nuk qëndron ngase ne kemi dorëzuar certifikate TS EN ISO 9606-12014 e jo sipas pretendimit te tyre se ne kemi dorëzuar certifikatën EN ISO 9609-1 2014. Diferenca ndërmjet kërkesës se AK-se ne dosje te tenderit për certifikatën dhe asaj te cilën ne kemi ofruar sikurse ne përgjigjen e ofruar AK-se ne Informacione Shtese dallimi qëndron ne vitet e rishikimit te standardit, andaj eliminimi ynë nga ky aktivitet prokurimit me këtë pretendim te AK-se ne nuk pajtohem e aq me pak kur ne dosje te tenderit AK-ja e ka kërkuar qe te prezantohet edhe me standard EKUIVALENTE. Andaj ne kërkojmë nga AK-ja qe vendimin për dhënie te kontratës te anuloj, dhe ne baze te këtyre fakteve te na shpërblej neve me kontrate si operator ekonomikisht me te favorshëm.”

Pretendimi i dytë (II) : “Si pike te dyte arsyetues për eliminimin ton ju si AK thoni qe: keni konstatuar qe ka ndërhyrje/modifikime ne origjinalitetin e tij. Një akuze te tille nga AK përkatësisht nga komisioni vlerësues është e papranueshme duke mos ofruar asnjë fakt te vetëm rreth këtij pretendimi. Ne kërkojmë përgjigje nga AK-ja ne baze te cilit verifikim komisioni vlerësues e ka konstatuar qe ka modifikime ne origjinalitetin e tij!? Për me tepër ju si AK nuk keni kërkuar as shpjegime e as qe i keni verifikuar origjinalitetet e tyre tek prodhuesit gjë qe ligji

ju lejon te kërkonte atë. Nuk mund te eliminohet nga një aktivitet prokurimit i cili është i “VLERES SE MADHE” me pretekstin “pretendim”, e pa kërkuar saktësinë e katalogun duke u mjaftuar me “konstatimet”. Me Konstatimin Tuaj ju thoni që ne kemi bere shkelje ligjore duke ofruar dokumentet te modifikuara e për këtë duhen te merren organet te tjera ligjore. Ne përgjigjen e afrouar nga AK-ja ne krekës për rishqyrtim rreth kësaj qeshje thotë që ne si OE nuk e kemi kontestuar këtë qeshje. Ne si OE me ane te kërkesës për rishqyrtim e përmendjes se kësaj qeshje veç se e kemi kontestuar këtë qeshje, kemi kërkuar po ashtu ne baze te cilave pretendimeve AK-ja dhe komisioni vlerësuar nga konstatuar ndërhyrje ne katalog ku vet katalogu e ka vulën dhe nënshkrimin te autorizuesit për shitjen dhe servisim te kamionëve. AK-ja dhe komisioni vlerësues kanë bere vlerësimin e ofertuesve me atë te konstatimeve pa kërkuar sqarime shtese e pa kërkuar saktësinë e tyre tek prodhuesit e ku veç dihet që ligji ju lejon atyre komunikimet te drejtpërdrejta me autorizuesit, AK-ja nuk e ka bere një gjë te tillë por vetëm na eliminon me Konstatimet e tyre. Andaj ne si OE nuk pajtohem si dhe e quaj te Pabaze një pretendim te tille nga AK-ja e cila nuk ka ofruar një fakt te vetëm por kërkon nga ne si OE te ofrojmë faktet që nuk ka ndërhyrje. Si është lartcekur vete nënshkrimi si dhe vula e autorizues është fakti primar dhe kryesore për origjinalitetin e katalogut te ofruar. AK-ja përmend ne përgjigjen ne kërkesë për rishqyrtim mos ankimin ton ne OSHP mbas përgjigjen ne kërkesë për rishqyrtim te datës : 06.03.2024 për pretendimin e tyre. Ne si OE nuk kemi bere një gjë e tillë ngase sikurse ne kërkesën te datës: 01.03.2024 dhe te datës: 13.06.2024 ne i kemi treguar AK-se që për pretendimin e tyre “ndërhyrjes ne katalog” do te merren organet te tjera ligjore, pretendim i tillë nga AK-ja nuk është ne korrespondence te OSHP për te një organi tjetër ligjor e ne një gjë te tille veç se e kemi procesuar.”

Pretendimi i tretë (III) : “ Shkeljet e AK-se Mbi Vendimin Mbi Dhënie e Kontratës. A. Pika 8.1&8.2 e FTD-se që ka te beje me kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare. Fillimisht operatori ekonomik i propozuar për kontrate dhe i cilësuar nga komisioni vlerësues I AK-se si I përgjegjshëm pjesëmarrjen e tij ne këtë aktivitet prokurimit e ka bere me degën e tij ne Kosove, pra si Vibtis Dega ne Kosove me numër biznesi: 810849218. Ai fillimisht nuk I ka ofruar AK-se dokumentet sipas dosjes se tenderit rreth qarkullimit financiar, e cila tek FTD-ja thotë, citoj: Deklarata e dorëzuar ne ATK apo kopjet e raporteve financiare dhe raportet e menaxhimit te certifikuar nga një firme e njohur e licencuar. Operatori ekonomik i propozuar për kontrate paraqet një dokument te titulluar si: BILANCI KS te vulosur e nënshkruar nga vet ai, që është ne kundërshtim me kërkesën e AK-se te cilën e kanë kërkuar si dëshmi një vërtetim nga ATK-ja ose nga një kompani e licencuar. Si mundet komisioni vlerësues ta cilësoj këtë operator ekonomik si te përgjegjshme kur nuk ofron dokumentat sipas kërkesës se AK-se!? Edhe ne dokumentin e ofruar për qarkullim vjetor ne Kosove ne 3 vitet (2020, 2021, 2022) ky operator ekonomik ne total I ka 2,084,427.00euro, ndërsa kërkesa e AK-se ka qen te jete jo me pak se 3,000,000.00euro, pra 915,573.00euro me pak sesa kërkesa e AK-se. Vlen te theksohet se ky operator ekonomik ka prezantuar shume dokumente nder to edhe qarkullimin financiar nga shteti i Shqipërisë ku e ka edhe selinë qendrore e është me emer si VIBTIS SH.P.K. Ne shume raste prezantimi i tij është me dy emra, me dy numra te biznesit ndërsa aplikimi për tender është bere

me Vibtis Dega Ne Kosove dhe ne procesverbal është vetëm si Vibtis Dega ne Kosove, pra jo si konsorcijum. Ne konsiderojmë se AK-ja përkatësisht komisioni vlerësues është dashur ta cilësoj si te papërgjegjshëm duke mos ofruar dokumentet respektive dhe te kerkuara nga AK për kompaninë me te cilën merr pjese ne këtë aktivitet prokurimit. B) Autorizimi nga Renault për shasi Ne konsiderojmë se komisioni vlerësues i AK-se nuk e ka bere ekzaminimin e autorizimit te dëshmuar nga Vibtis Dega Ne Kosove e cila është pale e katërt e autorizuar sipas dokumentit te ofruar: Fillimisht Renault Truck – France e autorizon Volvo Group Otomotiv Ticaret Limited Sirketi për shitje dhe servisim te kamionave RENAULT ne Republikën e Turqisë dhe i njëjti nuk e posedon autorizimin për prodhim te kamionave Renault, pra vetëm për shitje dhe servisim. Ne përmbajtje te tekstin autorizues Renault Truck France përmend qe autorizimi është për Turqi e jo edhe jashtë saj. Se dyti Volvo Group Otomotiv Ticaret Limited Sirketi e autorizon Ceyhan Automotiv San. Ve Dic. Për shitje te kamionave Renault. Ne përmbajtje te tekstit autorizues askund nuk permendet se Ceyhan Automotiv San. Ve Dic është i autorizuar për servisim, mirembajtje te kamionave e aq me tepër te prodhoj kamiona Renault dhe as qe Ceyhan Automotiv San. Ve Dic ka te drejte te autorizoj një kompani tjetër te beje shitje jashtë Turqisë, pasi Renault Truck-France veq se e ka limituar Volvo Group Otomotiv Ticaret Limited Sirketi qe këta nuk mund te shesin jashtë Turqisë. Ne fakt ne autorizim shkruan, citoj: “ will be produced in the future by the truck factory based in France”. Sipas kësaj kamionat do prodhohen ne France e jo ne Turqi. Se treti ne autorizimin te cilin Ceyhan Automotiv San. Ve Dic e autorizon Vibtis Dega Ne Kosove ne text përmendet, citoj: who are official dealer of Renault Truck Turkey – ky tekst është i pakuptim dhe i pabaze ngase ne autorizimet te dëshmuar Ceyhan Automotiv San. Ve Dic është i autorizuar nga Volvo Group Otomotiv e jo nga Renault Truck Turkey. Komisioni vlerësues nuk e ka vlerësuar këtë qeshje e cila dëshmon për saktësinë e këtyre autorizimeve. Po ashtu ne përmbajtjen e tekstit autorizues te Ceyhan Automotiv San. Ve Di për Vibtis Dega Ne Kosove shkruan, citoj: “ To submit a bid the purpose of which is to provide the following goods manufactured by our factories against the following tender. Nese shikohet autorizimi filimisht I Renault Truck France per Volvo Group aty shihet qe autorizimi ka te beje vetem me shitje, servisim dhe shërbimet mbas shitjes e askund nuk shkruan qe kamiona Renault do prodhohen Turqi, e njëjta nuk shkruan e as ne autorizimin e Volvo Group ndaj Ceyhan Automotiv San. Ve Dic. Si mund te prodhoj kamiona një kompani e caktuar e cila nuk ka te drejtën/autorizimin ta beje nje gje te tille!/? Këtu qartësisht shihet vërtetësia e autorizimeve te lëshuara ku se pari Ceyhan Automotiv San. Ve Dic nuk e din nga kush është I autorizuar dhe se dyti prap Ceyhan Automotiv San. Ve Dic thotë qe do prodhoje kamionat ne fabrikën e tyre! Si mundet komisioni vlerësues ta cilësoj këtë operator ekonomik te përgjegjshëm!/? C) Modeli i Ofruar nga Prodhuesi i Shasis: Edhe ne këtë deklaratë te kompanisë Ceyhan Automotiv San. Ve Dic thotë qe është dealer zyrtar i Renault Truck Turkey për te cilën e deklaroi qe ka adrese zyrtare ne France. Se pari Renault truck Turkey është me adrese ne shtetin e Turqisë e jo ne atë te Francës dhe se dyti Ceyhan Automotiv San. Ve Dic posedon autorizim nga Volvo Group (shih file i emërtuar si: Autorizim Renault FR – Renault TR – VIBTIS) e jo nga Renault Truck Turkey. Për me teper Ceyhan Automotiv San. Ve Dic është vetëm dealer ne një regjion te Turqisë dhe kursesi për shitje jashtë Turqisë gjë qe është lehte e verifikushme ne baze te kontratës qe Ceyhan Automotiv San. Ve Dic ka me Volvo Group Otomotiv Ticaret Limited Sirketi. Edhe këtu është për tu

çuditur si komisioni vlerësues e merr si të mirëqene këtë dokument kur autorizuesi kryesor për operatorin e propozuar për kontrate nuk e din nga kush e ka autorizimin dhe ku është me lokacion!? Si mund të cilësohet i përgjegjshëm një operator ekonomik i cili del në kundërshtim me dokumentet e prezantuar!? Si dëshmi është kërkuar që të tregohet edhe modeli i shasis me të cilin oferton, e njëjta nuk është. Andaj ne kërkojmë nga AK-ja ta bëjë rishqyrtimin e dosjes së tenderit dhe operatorin ekonomik të propozuar për kontrate ta cilësojë si të papërgjegjshëm. D) Autorizim nga Karba Për Superstruktur. Në autorizimin e prodhuesit të superstruktures Karba Otomotiv ai e autorizon Vibtis Dega Në Kosovë të participojë/ofertojë në këtë tender për produktet nga ky prodhues, por në autorizimin e lëshuar nga ky prodhues që ka të bëjë me shërbimet pas shitjes ky prodhues e autorizon Vibtis Shpk që është në Shqipëri. Sikurse në shumicën e dokumentave gjatë kësaj procedure ky operator ekonomik here paraqitet si Vibtis Dega Në Kosovë here si Vibtis Shpk. Vlenë të theksohet se në procesverbal ai nuk është në konsorcium por paraqitet vetëm si Vibtis Dega në Kosovë me numër biznesi të lartpërmendur. Mbulueshmërisë së dokumentacionit zakonisht e bënë duke përdorur dy emra që në fakt janë dy numra biznesi andaj ne konstatojmë se AK-ja është dashur të kërkojë sqarime përse paraqitet me dy emra!? Vibtis Shpk është me adresë në Tiranë – Shqipëri, sipas autorizimit të cilin Karba Otomotiv thotë që shërbimet mbas servisimit e bënë Vibtis Shpk i bëjë që kamionat me superstrukture që do kenë nevojë për servisim duhet të dërgohen në Tiranë për tu servisuar! Për neve si operator ekonomik ekonomikisht i përgjegjshëm është e papranueshme që të shpërblehet me kontratë operatori ekonomik të cilët paraqesin dokumentacionet sikurse të jenë në konsorcium! Komisioni vlerësues nuk e ka analizuar këto dokumentet dhe këto dëshmi të ofruar nga Vibtis Dega në Kosovë, i cili aplikon me dy numra biznesi me dy emra të ndryshëm dhe pastaj e merr si të mirëqenë që servisimet të kamionëve të kryhen në Tiranë (sipas autorizimit nga prodhuesi) e të cilat do kenë kosto të larta dhe vonesa për shkak të transportit. E) Vizatimi Teknik dhe Katalogu i Prodhuesit 1. Tek katalogu për kamion 8m³ në bazë të vizatimit teknik thuhet që gjatësia e përgjithshme është: 7100mm, gjatësia nga aksi i përparme tek pjesa e përparme e kamionit është: 1325mm, gjatësia ndërmjet dy akseve është: 3500mm si dhe gjatësia nga aksi i mbasem deri tek pjesa me e mbasem e kamionit është: 2300mm. Në bazë të këtyre informative atëherë kemi: 1325 3500 2300 = 7125mm pra gjatësia e përgjithshme e kamionit në bazë të vizatimit teknik është 7125mm e jo të sigur e prezantuar nga OE si 7100mm e njëjta është po ashtu edhe tek kamioni 16m³, gjatësia e përgjithshme: 8400mm, gjatësia nga pjesa e përparme e kamionit deri tek aksi i përparme është: 1420mm, gjatësia ndërmjet dy akseve: 4300mm, gjatësia nga aksi i mbasem deri tek pjesa me e mbasem e kamionit është: 2500mm, në bazë të këtyre informacione kemi: 1420 4300 2500 = 8220mm pra gjatësia e përgjithshme është 8220mm e jo 8400mm! Prapë edhe këtu komisioni vlerësues nuk e ka analizuar katalogun dhe vizatimin teknik si dhe nuk ka kërkuar se paku një që sqarim nga OE përse është ky ndryshim. Andaj ne kërkojmë nga AK-ja ta bëjë rishqyrtimin e vendimit dhe lenden ta kthejë në rivlerësim. 2. Në katalogun e prezantuar e cila e ka edhe nënshkrimin e kompanisë Ceyhan Automotiv San. Ve Dic për kamionin 8m³ Peshë bruto e shasisë së automjetit e kërkuar nga AK-ja është: maksimumi 10 ton, ndërsa operatori ekonomik I propozuar për kontratë ofron kamionin me peshë bruto të shasisë së automjetit me maksimum 11.6ton. Kjo bëjë në kundërshtim me kërkesën e AK-së. Edhe këtu komisioni vlerësues nuk e ekzaminuar si duhet kërkesën me

ofertën. Po ashtu edhe tek kamioni 16m³ Pesha bruto e shasis se automjetit te kërkuar nga AK-ja është: maksimum 18ton, ndërsa operatori ekonomik I propozuar për kontrate ofron kamionin me peshe bruto te shasis se automjetit me maksimum 20.1ton. Kjo bie ne kundërshtim me kërkesën e AK-se. Edhe këtu komisioni vlerësues nuk e ekzaminuar si duhet kërkesën me ofertën. F) Kopja e Certifikatave dhe Dëshmi Punësimi : Ne dokumentet e ofruara nga OE I propozuar për kontrata për këtë qeshje shihet se Karba Otomotiv ka ofruar nje liste me personat “te punesuar” si dhe certifikatat te saldatorve. Askund ne ata dokument nuk ekziston se paku nje nenshkrim nga keta personat “te punesuar” qe e vërtetojnë vërtetshin e asaj deklarata nga ky prodhues. Si mundet komisioni vlerësues te krijoj standarde te dyfishta, për neve si operator ekonomik pjesëmarrës te na kërkoj përmes letrës standard dëshmi punësimi – kontrata ndërsa për operatorin ekonomik te propozuar për kontrate te e pranoj vetëm një deklarata nga prodhuesi për te cilën askund nuk dëshmohet nëse vërtet këta persona janë punonjës tek ky prodhues, pra nuk kane kontrata ne dosje!/? Me ane te këtij veprimi AK-ja ka bere shkeljen e neni 7 te LPPK-se ku nuk i trajton te gjithë OE njësoj. G) Vërtetimi Tatimor, Vërtetim Gjykate, Vërtetim Gjykate Pronar Nen Hetime Tek qasja e mundësuar nga AK-ja ne dokumentet për operatorin ekonomik te propozuar për kontrate shihet qe dokumenti i ofruar është i pavlefshëm. Ai është i datës 21.03.2023 dhe validitetin e ka 90DITE. Data e aplikimit ka qen 07.09.2023 dhe si tillë do te duhej te cilësohej si I papërgjegjshëm. Dokumentet te tjera si vërtetim gjykate qe operatori ekonomik nuk është ne bankrotim si dhe vërtetimet gjykate qe pronar apo ndonjë udhëheqës nuk janë nen hetime Mungojnë. Për pretendimet tona drejtuar operatorit te propozuar për kontrate AK-ja ka kthyer përgjigjen me arsyetim se ne nuk jemi Pale e Interesit si dhe edhe pse ne kemi treguar disa shkelje ne dokumentacion te ofruar nga operatori i propozuar për kontrate AK-ja prap e cilëson si te përgjegjshëm. Fillimisht pasi lende rreth këtij aktiviteti prokurimit ka qen ne ankese ne OSHP, AK-ja me ane te email(shih te bashkangjitur) te datës: 13.05.2024 kërkon nga ne si OE qe me ane te një deklarata te konfirmojmë vazhdimin e ofertës tone, ne si OE i përgjigjemi thirrjes se AK-se dhe te njëjtën(shih te bashkangjitur) me datën: 13.05.2024 i konfirmojmë qe ne e vazhdojmë validitetin e ofertës pra ne jemi Pale e Interesit. Për shkeljet si dhe mospërputhja ne dokumentacione te operatorit te propozuar për kontrate janë te përpiluara me larte gjë qe AK-ja e cilëson te përgjegjshëm. H) Shkelja E Nenit 108/A Te LPP-se si dhe te NENI 61 te Rregullore për prokurimin publik Nr.001_2022 AK-ja përkatësisht zyrtari I prokurimit ka bere shkelje te neneve te lartpërmendura ngase këto neni thonj, citoj: Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e parashtrimit të kërkesës, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informatave shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në nenin 60.2 të kësaj rregullore. Ky afat, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë. Ne kërkesën ton për rishqyrtim kemi bere me datën: 13.06.2024 AK-ja ka kthyer përgjigjen ne kërkesën tone me datën: 25.06.2024 gjate kësaj kohe janë 7dite pune ne te cilën AK-se ju ka dashur te kthej përgjigje, ndërsa nenet e lartpërmendura thonë qe janë 3dite pune qe ta shqyrtoj kërkesën 3dite tjera shtese për te cilën ankuesi duhet te informohet. Ne si ankuesit një gjë te tille nuk jemi informuar nga asnjë letër te zyrtarit përgjegjës te prokurimit.”

Duke u referuar kërkesave si më sipër “Haxhijaha” ShPK konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Neni 1, 7, 59, 60, 72 të LPP-se. Kërkojmë nga OSHP të beje rishqyrtimin e vendimit, lenden ta kthej në rivlerësim, operatorin e propozuar për kontratë ta cilësoj si të papërgjegjshëm ndërsa ne si operatori ekonomik i përgjegjshëm ekonomikisht të na shpërblej me kontratë.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim: “Në kërkesën e DT nr. 8. kërkohet si në vijim :Kërkesa: OE duhet të dorëzoj një Certifikatë të vlefshme për testimin e kualifikimit të saldatorëve sipas standardit ENISO 9606-1 2017 (ose standardit kombëtar ekuivalent), të lëshuar nga një institucion i akredituar. Dëshmi: Kopje të certifikatës (me dëshmi punësimi-kontrata për marrëdhënie të punës ose marrëveshje për angazhim në punë) për testimin e kualifikimit të saldatorëve sipas standardit EN ISO 9606-1 2017. OE ka ofruar dëshmi Certifikatë ISO 9606-1 2014 për salduesit. OE Haxhijaha SHPK, pasi që ne ofertën e juaj kemi ofertuar me Certifikatë ISO , 9606-1 2014, për pesë (5) salduesit, e jo 9606-1 2017 siç është në DT. Me datën 14.02.2024, përmes „Letrave standarde për sqarim shtesë”, AK me kërkesë të komisionit vlerësues ka kërkuar sqarime nga OE lidhur këto Certifikata të cilat nuk janë ISO 9606-1 2017 siç është kërkuar në DT. OE është përgjigjur në këtë kërkesë, mirëpo i njëjti nuk i ka dërguar ato që janë kërkuar sipas DT, dëshmitë e ofruara nuk janë bindëse. Gjithashtu, tek OE Haxhijaha ShPK, në kërkesën nr.13 e DT thotë: OE duhet të dorëzoj: OE duhet të dorëzoj: Kërkesa : a. Katalogun e shashisë dhe b. Katalogun e superstrukturës-mbi ndërtimit, Dëshmi: (Katalogu i nënshkruar dhe i vulosur). O.E. si dëshmi për përmbushjen e kësaj kërkesë ka ofruar një katalog mirëpo tek i njëjti kemi konstatuar që ka ndërhyrje/modifikime në origjinalitetin e tij. Andaj komisioni vlerësues se është e papërgjegjshme. Tenderi i juaj Kërkesa e juaj për pjesëmarrje është administrativisht e papërgjegjshme. Së pari duhet sqaruar se ekzistojnë dy grupe të arsyeve për eliminimin e parashtruesit nga ky aktivitet i prokurimit. Grupi i parë i arsyeve ka të bëjë me faktin që parashtruesi nuk e ka dorëzuar certifikatën për EN ISO 9606-1 2017 mirëpo në vend të kësaj ka dorëzuar një certifikatë krejt tjetër (ENISO 9609-1 2014). Me këtë rast parashtruesi nuk e kundërshton faktin që nuk e ka dorëzuar certifikatën e kërkuar sipas dosjes së tenderit mirëpo pretendon se dallimi mes tyre nuk është shumë i madh. Fakt është që certifikata e dorëzuar nga parashtruesi nuk është sipas dosjes së tenderit dhe parashtruesi nuk ka arritur që të provojë të kundërtën as përmes sqarimeve shtesë të kërkuara nga komisioni vlerësues. Prandaj këto pretendime janë të pabazuara në tërësi. Ndërsa grupi i dytë i arsyeve për eliminim ka të bëjë me faktin se komisioni vlerësues ka konstatuar ndërhyrje/modifikime që është rreptësisht e ndaluar. Megjithatë parashtruesi nuk e ka kontestuar drejtpërdrejtë këtë arsye si të tillë por vetëm ka thënë se AK është dashur që të elaboroj më tepër ndërhyrjen e parashtruesit në katalog. Sidoqoftë, arsyet e eliminimit të parashtruesit janë konfirmuar si të sakta ndërsa pretendimet ankimore P1 dhe P2 janë gjetur si të pabazuara në tërësi. Vlen të shtohet po ashtu fakti se pas procesit të kaluar të rivlerësimit, parashtruesi me datë 01.03.2024 kishte dorëzuar kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 26.02.2024, me pretendimet e njëjta ankimore

si më sipër. Rrjedhimisht AK me datë 06.03.2024 kishte nxjerrë vendimin me të cilin kishte refuzuar si të pabazuar këtë kërkesë për rishqyrtim, me arsyetimin dhe përgjigjet e njëjta ndaj pretendimeve ankimore sikurse janë elaboruar më sipër. Megjithatë parashtruesi kundër këtij vendimi nuk ka parashtruar as ankesë në OSHP. Rrjedhimisht është pajtuar me vendimin e AK sipas të cilit është konfirmuar se oferta e parashtruesit është e papërgjegjshme. Parashtruesi është pajtuar me këto të gjetura dhe konstatime të AK pasi që të njëjtat nuk i kishte kontestuar fare në OSHP. Prandaj edhe nga ky këndvështrim parashtruesi ka demonstruar se fare nuk është palët e interesit për këtë aktivitet të prokurimit. Sa i përket pretendimeve ankimore të parashtruesit P3, P4, P5, P6 dhe P7, duhet theksuar faktin se këto pretendime janë të drejtuara kundër tenderuesit të rekomanduar për kontratë pavarësisht faktit vet parashtruesi është eliminuar si tenderues i papërgjegjshëm me arsyetimin e cituar si më sipër. Duhet sqaruar se parashtruesi përderisa vet ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të dëshmojë asnjë interes të vetëm material nga cilido rezultat i aktivitetit të prokurimit në raport me këto pretendime të tij ankimore të drejtuara kundër tenderuesve të tjerë. Përmes nenit 4 par. 1 nën par. 26 të LPP përcaktohet se "Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar". Nga këndvështrimi i kësaj dispozite të LPP, përderisa parashtruesi për vete ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit, dhe nuk ka arritur që të dëshmojë të kundërtën as me këtë kërkesë për rishqyrtim, atëherë i njëjti nuk është palë e interesuar në raport me pretendimet e tij ankimore kundër tenderuesve të tjerë. Megjithatë duhet cekur se tenderuesi i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar ofertë tërësisht të përgjegjshme. Në fakt oferta e tenderuesit të rekomanduar është ofertë e përgjegjshme me çmimin më të lirë në përputhje të plotë me kriterin e dhënies sipas DT. Prandaj rekomandimi për dhënie të kontratës nga komisioni vlerësues është në përputhje të plotë me kriteret e dhënies së kontratës sipas dosjes së tenderit. Me fjalë të tjera, edhe po të ishte palë e interesuar parashtruesi në raport me këto pretendime, sërish pretendimet e tij janë në tërësi të pabazuara. Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nën paragrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nën paragrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 10/07/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0578/2024, ndërsa me datë 21/07/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0578 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar (palë pa interes) dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaroi se pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk pajtohet lidhur

me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrirat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Haxhijaha” ShPK eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0578 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i pare : “ Me datën: 01.07.2024, OE “N. P.T. " Haxhijaha" ShPK.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0578, kundër njoftimit mbi vendimin e AK ku është rekomanduar për kontratë OE "VIBTIS" dega në Kosovë Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizimi me pajisje për pastrimin e kryeqytetit” me nr. të prokurimit: "616-23-7016-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Komuna e Prishtines. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 1,500,000.00 €. Lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues N. P.T. "Haxhijaha" ShPK të bëra me datën: 01.07.2024 në OSHP dhe duke e parë kronologjinë e tërë procedurës/lendes ku me datën: 26.02.2024 në platformën elektronike AK ka ngritur Njoftim mbi vendimin e AK me të cilin rast OE N.P.T. "Haxhijaha" ShPK nuk shfrytëzuar të drejtën e ankese në OSHP, po Ju pasqyrojmë kronologjinë e lendes lidhur me ankesat e bëra në AK dhe OSHP: 1. B-58 data: 27.10.2023: 1.1.Ankesa në OSHP me datë: 14.11.2023, (OE) N. P.T. "Haxhijaha"; 1.2.Ankesa në OSHP me datë: 16.11.2023, (OE) " VIBTIS " dega në Kosovë; 1.3.Vendimi i OSHP –së 2023/0906/ 0908 i datës 25.01.2024. 2. B-58 i datës: i datës: 26.02.2024: 2.1.Ankesa në OSHP me datë: 15.03.2024, (OE) " VIBTIS " dega në Kosovë; 2.2.Vendimi i OSHP –së 2024/0223 i datës 30.05.2024. 3. B-58 i datës: 10.06.2024: (ku është rekomanduar për kontratë (OE) " VIBTIS " dega në Kosovë); 3.1. Ankesa në OSHP me datë: 01.07.2024, (OE) N. P.T. "Haxhijaha". Eksperti shqyrtues sqaron çështjen kryesore mbi të cilën vuri vëmendje kryesore sa i përket ankesës në fjalë duke i marrë në konsideratë faktet dhe sqarimet e lartcekura, gjithashtu bazuar në B-58 Njoftimi mbi vendimin e AK datës: 26.02.2024 i cili vendim është publikuar nga AK OE ankues nuk ka paraqitur ankesë në OSHP. Eksperti shqyrtues konsideron se edhe për kundër këshillës juridike të dhënë nga AK në Letrën Standarde, OE N. P.T. "Haxhijaha" ShPK, nuk ka shfrytëzuar të drejtën e ankësës ndaj atij vendimi të autoritetit kontraktues konform dispozitave ligjore konkretisht nenit 108/A, nëse si palë e pa kënaqur kundër vendimit të AK edhe sipas nenit 109 të LPP në OSHP. Këtë nuk e ka bërë dhe si rrjedhojë është pajtuar me vendimin dhe me vlerësimin e tenderit për tenderin e tij për arsyet e cekura për këtë aktivitet të prokurimit. Në momentin kur një OE pajtohet me vendimin e AK-së e tij duke mos e atakuar vendimin e AK konform këshillës juridike dhe afateve ligjore të përcaktuara me ligj, ky OE e fiton statusin e palës pa interes konform nenit 4.1.26 të LPP. Për këtë çështje eksperti shqyrtues qëndron konsistent për shkak se në ekspertizën e tij nuk ka bërë shqyrtimin e pretendimeve ankimore të OE ankues sepse me rastin e publikimit të B-58 Njoftimi mbi Vendimin e AK –së të datës: 26.02.2024 ku secili OE i cili ushtron ankesë në OSHP, duhet

ta dëshmoj statusin e palës me interes për aktivitetin përkatës të prokurimit, sikurse është përkufizuar me nenin 4, paragrafi 1, nën – paragrafi 26, (shprehja “palë e interesuar”) lidhur me paragrafin 1, nën paragrafi 5, të nenit 111, të LPP e që këtë rast OE ankues nuk ka vazhduar me tutje me naksë në OSHP. a) nëse ankuesi nuk prezanton asnjë fakt apo fakte dhe provë përkitazi me vërtetimin e fakteve të pohuara se nuk qëndron dhe/ose është kundërligjor vlerësimi, respektivisht akti i atakuar i AK për eliminimin e tij/sajë dhe /ose nuk argumenton faktin /pohimin bazë se është i përgjegjshëm për aktivitetin e prokurimit për të cilin ka ushtruar ankesë. Andaj duke e parë të gjithë materialin e lartë përmendur OE ankues nuk ka interes Juridiko –material sipas nenit 4.1.26 të LPP dhe rekomandoj të mbetet në fuqi vendimi i AK - së, B-58 i datës 10.06.2024..”

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes .

Paneli Shqyrtues e mbështet këtë konstatim të ekspertit shqyrtues dhe po ashtu, konsideron se edhe për kundër këshillës juridike të dhënë nga AK në Letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar, të datës 26.02.2024, N. P.T. "Haxhijaha" Sh.p.k, (tani i OE ankues) nuk ka shfrytëzuar të drejtën e ankesës ndaj atij këtij vendimi të autoritetit kontraktues konform dispozitave ligjore konkretisht nenit 108/A, nëse si palë e pakënaqur kundër vendimit të AK edhe sipas nenit 109 të LPP në OSHP, pastaj nëse është e nevojshme edhe në gjykata kompetente. Këtë nuk e ka bërë dhe si rrjedhojë është pajtuar me vendimin dhe me vlerësimin e tenderit për eliminimin e tij për këtë aktivitet të prokurimit dhe për anulimin e aktivitetit në tërësi. Në momentin kur një OE pajtohet me eliminimin e tij duke mos e atakuar vendimin e AK konform këshillës juridike dhe afateve ligjore të përcaktuara me ligj, ky OE e fiton statusin e palës pa interes konform nenit 4.1.26 të LPP. Vlenë të theksohet se ky aktivitet i prokurimit është kthyer në ri-vlerësim vetëm në bazë të ankesës së njërit OE i cili ka atakuar vendimin e AK dhe e ka mbrojtur eliminimin e tij duke e fituar statusin e palës me interes. Për këto çështje OSHP qëndron konsistente në vendimet e saja sa i përket kësaj çështje dhe në vendimet e saja nuk ka bërë shqyrtimin e pretendimeve ankimore të OE ankues që i kanë pasur ndaj OE të cilët kanë qenë të eliminuar dhe të cilët nuk e kanë mbrojtur veten me kërkesë për ri-shqyrtim/ankesë duke i trajtuar si palë pa interes. Po ashtu edhe OE në ankesat e tyre, të rralla janë rastet kur atakojnë OE të cilët janë të eliminuar, të cilat OSHP nuk i shqyrton ngase i klasifikojnë si palë pa interes dhe pretendimet i kanë vetëm ndaj të rekomanduarit apo ndaj atyre të cilët janë të pasuksesshëm dhe kanë çmimin më të lirë se sa ankuesi. Ky konstatim ndërlidhet edhe me njoftimin e publikuar në ueb faqen e OSHP të datës 09.02.2023, ku i lajmëron AK/OE, se OE për të kualifikuar si palë me interes janë të obliguar të paraqesin pretendime ankimore të cilat synojnë të mbrojnë eliminimin e tyre, në të kundërtën kualifikohen si palë pa interes.

Sipas raportit të Eksperti shqyrtues i cili ka konsideruar si ne vijim: se edhe për kundër këshillës juridike të dhënë nga AK në Letrën Standarde, OE N. P.T. "Haxhijaha" Sh.p.k, nuk ka shfrytëzuar të drejtën e ankesës ndaj atij vendimi të autoritetit kontraktues konform dispozitave ligjore konkretisht nenit 108/A, nëse si palë e pa kënaqur kundër vendimit të AK edhe sipas nenit 109 të LPP në OSHP. Këtë nuk e ka bërë dhe si rrjedhojë është pajtuar me vendimin dhe me vlerësimin e tenderit për tenderin e tij për arsyet e cekura për këtë aktivitet të prokurimit. Në momentin kur një OE pajtohet me vendimin e AK-së e tij duke mos e atakuar vendimin e AK konform këshillës juridike dhe afateve ligjore të përcaktuara me ligj, ky OE e fiton statusin e

palës pa interes konform nenit 4.1.26 të LPP. Për këtë çështje eksperti shqyrtues qëndron konsistent për shkak se në ekspertizën e tij nuk ka bërë shqyrtimin e pretendimeve ankimore të OE ankues sepse me rastin e publikimit të B-58 Njoftimi mbi Vendimin e AK –së të datës: 26.02.2024 ku secili OE i cili ushtron ankesë në OSHP, duhet ta dëshmoj statusin e palës me interes për aktivitetin përkatës të prokurimit, sikurse është përkufizuar me nenin 4, paragrafi 1, nën – paragrafi 26, (shprehja “palë e interesuar”) lidhur me paragrafin 1, nën paragrafi 5, të nenit 111, të LPP e që këtë rast OE ankues nuk ka vazhduar me tutje me ankesë në OSHP. a) nëse ankuesi nuk prezanton asnjë fakt apo fakte dhe provë përkitazi me vërtetimin e fakteve të pohuara se nuk qëndron dhe/ose është kundërligjor vlerësimi, respektivisht akti i atakuar i AK për eliminimin e tij/sajë dhe /ose nuk argumenton faktin /pohimin bazë se është i përgjegjshëm për aktivitetin e prokurimit për të cilin ka ushtruar ankesë. Nga ana tjetër AK mban përgjegjësi konform nenin 59.1 lidhur me vlerësimin e bërë kundrejt OE të rekomanduar nderlidhur edhe me nenin 24.2 të LPP-së.

atëherë paneli vlerëson se është në përgjegjësi të AK edhe përzgjedhja e OE të rekomanduar për kontratë. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivel qendror dhe lokal) gëzon autonomi në projektin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen bërë (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendosin po ashtu edhe për OE të rekomanduar për marrjen e kontratave edhe në neni 24 paragrafi 2 i LPP cituar ”Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të mbajtur që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të këtyre kontratave të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron.

Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur në konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafet 1 dhe 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkëlqen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - N. P.T. " Haxhijaha" Sh.p.k.**
- Arkivës së OSHP-së: